

VENDIM
Nr. 97, datë 4.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 28.10.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LIBRAZH D, TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “k”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Librazhd, të qarkut Elbasan, bashkëlidhur vendimit nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 426 dhe 427 (katërqind e njëzet e gjashtë dhe katërqind e njëzet e shtatë), gjithsej 2 (dy) prona.

2. Kalimin në pronësi të Bashkisë Librazhd të pronave me nr. 426 dhe 427, të llojit “truall”, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Librazhd.

3. Bashkisë Librazhd i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Bashkia Librazhd dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE
(Per inventarin e pronave te vecanta)

Bashkia : LIBRAZHD

Fusha e perdorimit te Prones : Strehim

Identifikoi Jonuz Gjokola (Specialist)

Supervizoi Mirela Biba (Specialist)

Aprovoi Shefki Çota Kryetar i Bashk

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadastrale &Indeksi I hartes	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Emri I Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga sip Totale sa ndertesa (m2)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni Enti perd. Statusi juridik perdorimit	Te dhena tjera (Shenime vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
426	2446 LB- C-4,D-4	3/365 T	Truall	Truall I lire lagje ushtarakut Librazhd	773,75	-	Truall i lire	Bashkia Librazhd	Bashkia Librazhd	Mbi kete truall do te ndertohen banesa sociale perfshire sip.funksionale
427	2446 LB- C-4,D-4	3/368 T	Truall	Truall I lire lagje ushtarakut Librazhd	165	-	Truall i lire	Bashkia Librazhd	Bashkia Librazhd	Mbi kete truall do te ndertohen banesa sociale perfshire sip.funksionale



PLAN RILEVIMI

Shkalla 1 : 500

Sipërfaqja totale e pasurisë 773.75 m²


Truall i lirë

ZK.2446 NR.PASURISE 3/365T
Indeksi i hartës LB - C - 4, D - 4

Poseguesi :
Bashkia Librazhd

MIRATOHËT
KRYETARI I BASHKISË LIBRAZHËD
SHEFKI ÇOTA

PER ZYREN E SHERBIMEVE DHE Z.P.T.K.ZH
JONUZ GJOKOLA VELI DASHI





PLAN RILEVIMI

Shkalla 1 : 500

Sipërfaqja totale e pasurisë 165.00 m²

Truall i lire

ZK. 2446 NR. PASURISE 3/368 T
Indeksi i hartës LB - C - 4, D - 4

Poseduesi :

Bashkia Librazhd

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE LIBRAZHID
SHEFKI ÇOTA

PER ZYREN E SHERBIMEVE DHE Z.P.T.K.ZH
JONUZ GJOKOLA VELI DASHI

